

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 529 Prot.

Tiranë, më 28.072015

VENDIM Nr. 85 datë 15.07.2015

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 46, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.10, të datës 15.07.2015, pasi shqyrtoi *Relacionin e gërmimit, dokumentimit dhe mbulimit të varreve të zbuluara në mënyrë rastësore, si rezultat i punimeve bujqësore në fshatin Krahës të Tepelenës, realizuar nga ASHA,*

VENDOSI:

- I. Të miratojë *Relacionin e gërmimit, dokumentimit dhe mbulimit të varreve të zbuluara në mënyrë rastësore, si rezultat i punimeve bujqësore në fshatin Krahës të Tepelenës, realizuar nga ASHA.*
- II. Gjetjet arkeologjike të përfuara nga gërmimi arkeologjik i shpëtimit, të depozitohen pranë ambienteve të DRKK-Gjirokastrër përveç monedhave të cilat të depozitohen pranë Sektorit të Numizmatikës në Institutin e Arkeologjisë, shoqëruar me listën përkatëse, pasi të jetë kryer pastrimi dhe regjistrimi i tyre pranë ASHA.
- III. Për zonën në fshatin Krahës-Tepelenë ku janë identifikuar gjetje rastësore, në varësi të potencialit arkeologjik ASHA në bashkëpunim me DRKK Gjirokastrër dhe institucionet përkatëse, të përgatisë dokumentacionin dhe të vijojë më tej procedura për shpalljen e saj "Zonë e mbrojtur".
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO

